

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije sa vijon:

34/3

1. Lëvizja e fondit të Muzeut Historik Kombëtar gjatë rikonstruksionit të tij është miratuar.
2. Zhvendosja e fondit të Muzeut Historik Kombëtar është përcaktuar në Planin e Evakuimit të Artefakteve, i miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Muzeve. Sipas këtij plani, objektet muzeore janë zhvendosur brenda godinës së Muzeut Historik Kombëtar, konkretisht në sallën e Pavionit të Etnografisë, në të dy katet e saj.
3. Fondi i Galerisë Kombëtare të Arteve është zhvendosur përkohësisht në Muzeun Historik Kombëtar si masë e përkohshme gjatë procesit të rikonstruksionit të godinës së Galerisë. Ky fond do të qëndrojë në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar deri në përfundimin e punimeve dhe zhvendosjen përfundimtare në godinën e rikonstruktuar të Galerisë së Arteve. Hapësira ku ndodhet fondi i Galerisë është në të njëjtën pjesë të godinës ku ruhet edhe fondi i Muzeut, dhe kjo zonë do të përforcohet pas krijimit të kushteve të nevojshme për ruajtjen e sigurtë të fondeve.

Me respekt

Fatbardha/Koordinator